



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 28.3.2023

Nr: 213

Ora: 16:57

VENDIM

PËR

**NDALIMIN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK TË BASHKISË CËRRIK,
UJËSJELLËS KANALIZIME CËRRIK**

Sot më datë 28.3.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Bashkia Cërrik, Ujësjellës Kanalizime Cërrik

OBJEKTI: Ndalim i zhvillimit të veprimtarive me karakter publik, të raportuar nga Bashkia Cërrik, Ujësjellës Kanalizime Cërrik.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, neni 91 dhe 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Në datë 25.3.2023, Bashkia Cërrik, Ujësjellës Kanalizime Cërrik ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 4 (katër) veprimtari publike me objekt:

1. “Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike”, për t’u zhvilluar në datë 30.3.2023 ora 13:00, me vend të zhvillimit në “Shales, NJA Shales”, me folës kryesorë:

Data: 28.3.2023 Nr: 213
Ora: 16:57



“Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter publik të Bashkisë Cërrik, Ujësjellës Kanalizime Cërrik”

Damian Gjijnuri (Drejtues Politik Qarku), Andis Salla (Kryetari i Bashkisë), pjesëmarrësit: Damian Gjijnuri, Andis Salla, administratori njësisë, komunitet.

2. *“Ndërtim banese Klos”*, për t’u zhvilluar në datë 30.3.2023 ora 13:30, me vend të zhvillimit në *“Klos”*, me folës kryesorë: Damian Gjijnuri (Drejtues Politik Qarku), Andis Salla (Kryetari i Bashkisë), pjesëmarrësit: Damian Gjijnuri, Andis Salla, administratori njësisë, komunitet.
3. *“Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike”*, për t’u zhvilluar në datë 30.3.2023 ora 14:00, me vend të zhvillimit në *“Shtepanjë”*, me folës kryesorë: Damian Gjijnuri (Drejtues Politik Qarku), Andis Salla (Kryetari i Bashkisë), pjesëmarrësit: Damian Gjijnuri, Andis Salla, administratori njësisë, komunitet.
4. *“Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike”*, për t’u zhvilluar në datë 30.3.2023 ora 15:00, me vend të zhvillimit në *“Shtermen”*, me folës kryesorë: Damian Gjijnuri (Drejtues Politik Qarku), Andis Salla (Kryetari i Bashkisë), pjesëmarrësit: Damian Gjijnuri, Andis Salla, administratori njësisë, komunitet.

Referuar nenit 92, pikat 1, 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, parashikohet se institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Në rast se KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve, konstaton nga informacioni, sipas pikës 3 të këtij neni, se veprimtaria mund të përbëjë keqpërdorim të burimeve shtetërore, atëherë ajo urdhëron ndalimin e zhvillimit të saj.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nga të dhënat e paraqitura në raportim ka konstatuar se, aktivitetet e zhvilluara nga institucioni publik, Bashkia Cërrik, Ujësjellës Kanalizime Cërrik, me pjesëmarrjen e personave partiakë përbën veprimtari të ndaluar, në kuptim të nenit 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, nenin 92 pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

VENDOS:

1. Ndalimin e zhvillimit të veprimtarive publike me datë 30 mars 2023 me temë:
 - a) *“Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike”, me vend të zhvillimit në “Shales, NJA Shales”,*
 - b) *“Ndërtim banese Klos”, me vend të zhvillimit në “Klos”,*
 - c) *“Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike”, me vend të zhvillimit në “Shtepanjë”,*
 - ç) *“Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike”, me vend të zhvillimit në “Shtermen”,*
2. Vendosjen e shënimit “Ndaluar nga KQZ” në ndërfaqen e raportimit.
3. Njoftimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive të mos lejojë transmetimin apo pasqyrimin në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione.
4. Ky vendim i njoftohet palëve nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI